



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



ZYRA PËRMBARIMORE

SUELA NDRECA

2198
260324

Nr. 432/5 Prot

Tiranë, më 27.02.2024

Nr. 432 Dosje

URDHËR PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Për dijeni: **Debitorit:** Shoqërisë “Bajrami N” shpk – Nipt K027272020
Administrator Z. Andon Prifti
Adresa: Labinot fushe XIBRAKE, Rruga Elbasan-Xibrake km.13, zk.3864,
pasurite nr.734/1+732+738/9, Elbasan

Kreditorit: Shoqërisë “ENO TD” sh.p.k.
Administrator Z. Tonin Dedaj
Adresa: Lagjia nr.14, Autostrada Durrës Tiranë, pranë karburant Kastrati, Durrës

Unë, Suela Ndreca, Përmbaues Gjyqësor, në referim të titullit ekzekutiv Fatura Tatimore e Shitjes me TVSH për të cilin është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit Vendimi Nr. Regj Them. 335/789 (90109-2608-11-2023), Datë rregjistrimi 08.09.2023, datë rishortimi 28.12.2023, Nr. Vendimi 335/789, Datë vendimi 23.01.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Durrës, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbauese Nr. 432 kërkesën e kreditorit Shoqërisë “ENO TD” sh.p.k., ndaj debitorit Shoqërisë Bajrami N sh.p.k.

Në referim të nenit 519 të K.Pr.Civile është marrë Vendim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit. Përsa më sipër në referim të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbauesor Gjyqësor Privat”,

URDHËROJ:

1. Qendrën Kombëtare të Biznesit, të bëjë vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi dokumentacionin e aktiveve, kuotat/aksionet e palës debitore si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre, moskryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar, si dhe të mospajisë me asnjë lloj dokumentacioni debitorin Shoqërisë “Bajrami N” shpk – Nipt K027272020, Administrator Z. Andon Prifti, Adresa: Labinot fushe XIBRAKE, Rruga Elbasan-Xibrake km.13, zk.3864 pasurite nr.734/1+732+738/9, Elbasan.
2. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorët e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm të pronësisë së mjeteve të luajtshme në emër të debitorëve të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve.

Përmbauesi GJYQËSOR
Suela NDRECA

